



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Këshilli Shtetëror i Pranimit

Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist të Shkencave Shoqërore, Grupi Nr.14, i themeluar me Vendim Nr.15/99, të datës. 30.09.2022, e në mbështetje të nenit 99 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administratave, neni 34 paragrafi 12 i Ligjit për Zyrtar Publik si dhe nenit 17 të Rregullores nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datë: 06.03.2023 nxjerrë këtë:

Nr. 354/2023
Datë. 06.03.2023

V E N D I M

Për shtyrje të afatit për përfundimin e procedurës së konkurrimit për grupin “Specialist të Shkencave Shoqërore”

- I. Shtyhet afati i përfundimit të procedurave të rekrutimit për 4 pozitat Specialist të shkencave shoqërore i shpallur me datë: 16.12.2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, për Grupin “Specialist të Shkencave Shoqërore“, me nr. RN00010631 – Asistent Ekzekutiv, RN00010634 – Zyrtar për Arkiva 1, RN00010632 – Zyrtar për Arkiv 4, RN00010635 – Zyrtar Multimedial.
- II. Afati sipas pikës I të këtij Vendimi shtyhet tridhjetë e pesë (35) ditë kalendarik nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- III. Obligohet DMZP-ja të njoftoj të gjithë kandidatët të cilët e kanë kaluar testin me shkrim të mbajtur me datë. 28.02.2023, për shtyrjen e këtij afati.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist të Shkencave Shoqërore, Grupi Nr.14, është në proces të rekrutimit për kandidatet e konkursit Specialist të shkencave shoqërore për katër pozita, dhe për shkak të madh të kandidatëve për zhvillimin e intervistave, vendosi zgjatjen e afatit për përfundimin e proceduarve të rekrutimit për pozitën Asistent Ekzekutiv, Zyrtar për Arkiva 1, Zyrtar për Arkiv 4, Zyrtar Multimedial.

Andaj, nga kjo që u tha më lart u vendos si në Dispozitiv të këtij Vendimi.

Robralvi

**Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore
për Grupin Specialist të Shkencave Shoqërore, Grupi Nr.14,**